



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komuna e Istogut  
Opština Istok - Municipality Istog



DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA  
SEKTORI I TATIMIT NË PRONË

Data: 03.11.2025

N J O F T I M

Të nderuar qytetarë të Komunës së Istogut,

Sektori i Tatimit në Pronë njofton të gjithë pronarët e pasurive të paluajtshme, përfshirë objektet banesore, afariste dhe pronat e tjera, se ata kanë **detyrim ligjor për pagesën e tatimit vjetor në pronë.**

Duke u mbështetur në Ligjin Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, të ndryshuar dhe plotësuar me Nenin 112 të Ligjit Nr. 08/L-176, si dhe në pajtim me Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, **Sektori i Tatimit në Pronë, në kuadër të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa të Komunës së Istogut, informon qytetarët për mundësinë e lidhjes së Kontratës Administrative për pagesë me këste të tatimit në pronë.**

Të gjithë personat fizikë dhe juridikë që kanë detyrime tatimore të papaguara **mbi 300 euro** mund të përfitojnë nga kjo mundësi ligjore duke lidhur **Kontratë Administrative për pagesë me këste**, në mënyrë që të shmangin procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm.

*Për çdo sqarim shtesë, për marrëveshje për pagesë ose lidhje të kontratës për këste, qytetarët mund të konsultohen me zyrtarët komunalë të Tatimit në Pronë dhe të paraqiten personalisht në **Zyrën nr. 109, kati i parë**, në ndërtesën e Komunës së Istogut, gjatë orarit zyrtar të punës.*

Me respekt,  
SEKTORI I TATIMIT NË PRONË  
Komuna e Istogut